



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.345/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Faton Xhaqkaj, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) – Dega në Shtime, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) – Dega në Shtime, për shkak të mbulimit të posterit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 08.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET ankesa A.nr.345/2021 e datës 05.02.2021 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, t'i shqiptohet gjobë për shkeljen e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me rastin e vendosjes së posterit/bilbordit në pjesën e dedikuar për reklamim por duke e mbuluar posterin e subjektit ankues.

A r s y e t i m

Me datën 05.02.2021, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK, i cili pretendon se me datën 29.01.2021 ka bërë kërkesë për lejim e shfrytëzimit të hapësirës publike për vendosjen e posterit në billboard, kurse me datë 02.02.2021 Komuna ka lejuar shfrytëzimin sipas kërkesës së subjektit, ndërsa përkundër kësaj subjekti LVV pasi që është vendosur posterit i PDK-së mbi të kanë vendosur reklama të subjektit të tyre, duke shkelur dispozitat ligjore, përkatësisht shkelja e nenit 33, paragrafi 1, pika a) të ligjit Nr.03L/073. Ankesës i kanë bashkangjitur edhe disa fotografi të printuara si dëshmi.

Në përgjigje në ankesë të datës 06.02.2021, subjekti politik LVV pretendojnë se në shkresat e lëndës konstatohet qartë se parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur lejen për shfrytëzimin e hapësirës për vendosjen e billboardit në rrugën rajonale “Adem Jashari”. Kësisoj ata kanë abuzuar me të drejtën e ankesës duke bërë ankesë të rrejshme. Prandaj billboardi që është vendosur paraprakisht është pa leje të Komunës dhe një vendosje e tillë përbën shkelje të nenit 33 pika b) e LZP. Gjithashtu ka theksuar se, LVV me datë 26.01.2021 ka lidhur kontratë me kompaninë “Selmans Network SHPK”, ku sipas nenit 1 të kësaj kontrate kompania në fjalë është e obliguar që të vej në dispozicion hapësirat reklamuese për LVV për fushatën zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme Parlamentare 2021, në përputhje me këtë marrëveshje. Si dëshmi për këtë kanë

bashkangjitur pjesë të kontratës ndërmjet subjektit LVV dhe Kompanisë “Selmans Netëork SHPK”. Në nenin 2 të kësaj kontrate theksohet se “hapësirat e kontraktuara që duhet të vihen në dispozicion qiradhënësit janë si më poshtë {...}. Në konkretizim të kësaj, në pikën 14 të nenit 2 të Kontratës theksohet se “Billbord 059/B Shtime. Pra, billbordi në rrugën rajonale “Adem Jashari” në Shtime është vendosur mbi bazën e kontratës mbi dhënien me qira të hapësirave reklamuese duke përfshirë edhe billbordin 058/B Shtime. Kjo vërteton qartë se LVV ka kontratë të lidhur me kompaninë në fjalë, e cila demanton pretendimet e pavërteta të parashtruesit të ankesës dhe i propozon Panelit që ta refuzoj si të pabazuar ankesën e palës parashtruese kundër LVV dhe Pzap-i ti shqiptoj gjobë palës parashtruese PDK për shkak të shkeljes së nenit 33 pika b) në ndërlidhje me pikën k) të LZP.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se subjekti politik PDK, ka parashtruar ankesë kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me pretendimin se pjesëtarët e kësaj partie kanë shkatërruar posterët e ankuesit dhe se mbi ta kanë vendosur posterët e tyre, madje si provë kanë bashkangjitur disa foto ku shihen posterët e dëmtuar. Pas pranimit të ankesës në PZAP, e njëjta i është dërguar subjektit LVV për përgjigje në ankesë.

Subjekti politik LVV me datë 06.02.2021, ka paraqitur përgjigje në ankesë, duke i kundërshtuar në tersi pretendimet e ankuesit të parashtruara në ankesë dhe duke kërkuar që ankesa të refuzohet e pa bazuar.

Paneli pas vlerësimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura në ankesë të cituara më lartë si dhe përgjigjes në ankesë dhe provat e bashkangjitura në të, erdhi në përfundim se ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) – Dega në Shtime, ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) – Dega në Shtime, e paraqitur për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – mbulim posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik, është i pa bazuar. Në rastin konkret subjekti politik PDK, pretendimet e bëra në ankesë nuk ka arritur ti mbështes me prova të mjaftueshme që do të dëshmonin se pretendimet e tyre janë të bazuara. Në ankesën e tyre është cekur se si provë ankesës i bashkëngjitet leja e lëshuar nga ana e Komunës e datës 02.02.2021, por e njëjta nuk i është bashkangjitur shkresave, dhe ky pretendim mbetet vetëm nivel pretendimesh dhe pa prova konkrete. Po ashtu nga përgjigja në ankesë e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje vërtetohet fakti se ky subjekt ka kontratë për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese të Kompanisë “Selmans Network SHPK, ku dhe ka bashkangjitur kontratën në fjalë.

Nga të cekurat më larte Paneli erdhi në përfundim se pretendimi i palës ankuese nuk është në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 33 pika b) të LZP b), me të cilin theksohet se: “vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e

sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”. Në rastin konkret subjekti politik PDK, nuk ka bashkangjitur prova që e bëjnë të besueshme faktin se subjekti politik VV, ka bërë shkelje të dispozitës së lartcekur të pretenduar me ankesë, pasi që e njëjta nuk ka arritur ta paraqes lejen nga Komuna, për vendosjen e posterave në vendet e pretenduara në ankesë dhe as nuk ka arritur ta dëshmoj se vendosja e posterave nga LVV, është në kundërshtim me dispozitën ligjore të cekur më lartë, andaj si e tillë është refuzuar nga ky panel, duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më lartë, duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 345/2021 më datën 08.02.2021

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së